

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS

JANAR - QERSHOR 2026

Mitrovicë e Jugut, Korrik 2026

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje	3
Sektori për Arsim	4
Planifikimi, koordinimi dhe administrimi i proceseve edukativo-arsimore	4
Monitorimi, mbështetja dhe sigurimi i cilësisë në arsim.....	4
Gjithëpërfshirja dhe mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore	5
Vlerësimi i jashtëm dhe analiza e rezultateve dhe të dhënave statistikore	6
Garat, aktivitetet edukativo-arsimore dhe zhvillimi profesional	7
Bashkëpunimi ndërinstitutional, projektet dhe hulumtimet në institucionet arsimore	7
Mbrojtja, siguria dhe parandalimi i dukurive negative në institucionet arsimore	8
Sektori për Administratë dhe Financa	9
Buxheti	9
Obligimet e papaguara.....	10
Ndryshimet në Paga.....	10
Punët/Aktivitetet e Realizuara në periudhën Janar – Qershor 2026.....	10



Hyrje

Drejtoria e Arsimit, gjatë periudhës janar - qershor 2026, ka realizuar një sërë veprimtarish dhe angazhimesh institucionale në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të sistemit të arsimit parauniversitar në komunë, duke u fokusuar në sigurimin e cilësisë së procesit edukativo-arsimor, mbështetjen e institucioneve arsimore dhe krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e tyre të qëndrueshëm.

Përmes Sektorit për Arsim, Drejtoria e Arsimit ka qenë e angazhuar në koordinimin, monitorimin dhe mbështetjen e institucioneve edukativo-arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, në analizimin e rezultateve dhe proceseve arsimore, në fuqizimin e arsimit gjithëpërfshirës, në adresimin e nevojave të nxënësve dhe mësimeve, si dhe në zhvillimin e aktiviteteve që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Në mbështetje të këtyre proceseve, Sektori për Administratë dhe Financa ka siguruar menaxhimin e proceseve administrative dhe financiare të drejtorisë, përmes planifikimit dhe realizimit të buxhetit, mbështetjes së institucioneve arsimore me furnizime dhe shërbime të nevojshme dhe trajtimit të çështjeve administrative që mundësojnë funksionimin e rregullt të sistemit arsimor.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Arsimit ka realizuar një analizë të gjendjes në institucionet edukativo-arsimore, ka identifikuar sfidat kryesore dhe ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e proceseve, me qëllim të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit ka vazhduar punën në adresimin gradual të këtyre çështjeve përmes planifikimit, koordinimit me institucionet përkatëse dhe ndërmarrjes së masave konkrete, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve arsimore dhe krijimin e kushteve më të mira për nxënësit dhe stafin arsimor.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës janar - qershor 2026, sipas sektorëve përkatës.



Sektori për Arsim

Gjatë periudhës janar - qershor 2026, Sektori për Arsim ka realizuar aktivitetet e planifikuara me qëllim të organizimit dhe mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor në institucionet edukativo-arsimore të komunës. Aktivitetet janë fokusuar në planifikimin dhe koordinimin e proceseve edukativo-arsimore, monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në arsim, mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës, realizimin e vlerësimeve të jashtme, organizimin e garave dhe aktiviteteve arsimore, si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët relevantë. Aktivitetet e realizuara janë paraqitur më poshtë sipas fushave kryesore të përgjegjësisë së sektorit.

Planifikimi, koordinimi dhe administrimi i proceseve edukativo-arsimore

- Hartimi i planit të punës së Sektorit për Arsim, si dhe koordinimi i integritetit të planeve të dy sektorëve në planin e përbashkët të punës së Drejtorisë së Arsimit;
- Hartimi i kalendarit vjetor për vizitat monitoruese dhe mbështetëse në institucionet arsimore;
- Koordinimi i përgatitjeve të nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2025/26 në të gjitha institucionet edukativo-arsimore;
- Evidentimi dhe analiza e raporteve mujore të institucioneve arsimore, si dhe raporteve të përgjithshme për gjysmëvjetorin e dytë, me adresimin e çështjeve të evidentuara në to;
- Raportimi për fushën e arsimit në kuadër të Planit Gjithëpërfshirës për përmbushjen e obligimeve të Agjendës Evropiane për periudhën janar – qershor 2026;
- Raportimi i të dhënave të Drejtorisë së Arsimit në kuadër të Performancës Komunale 2025;
- Përgjigjja në shkresa të ndryshme (kërkesa, propozime, ankesa etj.) të parashtruara nga palë të ndryshme, organizata, media dhe institucione;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me MASH-in, SIA-n, Policinë e Kosovës dhe drejtoritë e tjera komunale;
- Grumbullimi i kërkesave për tekste shkollore nga të gjitha institucionet arsimore për vitin shkollor 2026/27, sipas katalogut të MASH-it.

Monitorimi, mbështetja dhe sigurimi i cilësisë në arsim

- Realizimi i 36 vizitave monitoruese dhe mbështetëse në institucionet arsimore të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, sipas kalendarit vjetor të vizitave monitoruese për vitin 2026, si dhe adresimi i gjetjeve të evidentuara në raportet monitoruese;
- Mbështetja e institucioneve arsimore në raportimin e suksesit dhe mungesave në SMIA për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2025/26, si dhe analiza e rezultateve në nivel komune;



- Analiza e procesit të përzgjedhjes së Koordinatorëve të Cilësisë (KC) dhe nxjerrja e rekomandimeve;
- Takimi me koordinatorët e cilësisë të të gjitha institucioneve arsimore për krijimin e rrjetit të bashkëpunimit në nivel komune;
- Mbështetja e institucioneve arsimore në rishikimin dhe hartimin e planeve zhvillimore të shkollës dhe rregulloreve të brendshme;
- Mbështetja e procesit të vlerësimit të brendshëm të performancës së mësimdhënësve për përtëritjen e licencës, ku janë vlerësuar dhe rilicencuar 188 mësimdhënës brenda kësaj periudhe.


Gjithëpërfshirja dhe mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

- Identifikimi dhe adresimi i nevojave në nivel komune, në bashkëpunim me institucionet edukativo-arsimore, për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (0, 1, 2 dhe 3);
- Identifikimi dhe adresimi i nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në nivel komune, si dhe përgatitja e raportit përfundimtar nga komisioni i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës;
- Plotësim-ndryshimi i Ekipit për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, në përputhje me UA nr. 02/2024;
- Funksionalizimi i Ekipit për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, ku gjatë muajit qershor janë vlerësuar 7 fëmijë;
- Analiza e situatës së përfshirjes së nxënësve nga komunitetet në institucionet edukativo-arsimore;
- Takimi me pedagogët, psikologët, mësimdhënësit mbështetës dhe asistentet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të të gjitha institucioneve arsimore për krijimin e rrjetit të bashkëpunimit në nivel komune;
- Shqyrtimi i rasteve me tendencë të braktisjes dhe parandalimi i braktisjes në koordinim me shkollat, MASH, QPS, Policinë në Komunitet dhe akterët e tjerë relevant;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Ekipin Mobil të Qendrës Burimore “Nëna Terezë” dhe adresimi i gjetjeve nga raportet e vizitave këshillëdhënëse dhe profesionale për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Bashkëpunimi me Shoqatën Down Syndrome Kosova për realizimin e aktivitetit “Një Kartolinë Për Ty” të miratuar nga MASH;
- Koordinimi me prindërit dhe institucionet arsimore për integrimin e nxënësve të riatdhesuar.




Vlerësimi i jashtëm dhe analiza e rezultateve dhe të dhënave statistikore

- Koordinimi dhe organizimi i Testit të Maturës Shtetërore 2026 për nxënësit e klasave të dymbëdhjeta, si dhe analiza e rezultateve sipas shkollave, ku kalueshmëria në nivel komune është 74.25%;



- Koordinimi dhe organizimi i Testit të Arritshmërisë 2026 për nxënësit e klasave të nënta, si dhe analiza e rezultateve sipas lëndëve dhe shkollave, ku arritshmëria në nivel komune është 45.06%;



- Realizimi i procesit të regjistrimit të nxënësve në klasën përgatitore, klasat e para dhe klasat e dhjeta në gjimnaze dhe shkolla profesionale.
- Evidentimi dhe analiza e rënies së numrit të nxënësve, me fokus të veçantë në zonat rurale dhe shkollat e mesme të larta, si dhe vlerësimi i ndikimit të kësaj dukurie në normat e mësimdhënësve;

Garat, aktivitetet edukativo-arsimore dhe zhvillimi profesional

- Koordinimi i procesit të përzgjedhjes së mësimdhënësit të dalluar në nivel shkolle dhe komune;
- Koordinimi i organizimit të garave në nivel shkolle, komune dhe vendi në lëndën e matematikës;
- Koordinimi i organizimit të Olimpiadës së Përbashkët të Gjuhës Shqipe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për nxënësit e klasave të nënta, në nivel shkolle dhe komune;
- Koordinimi i garave në nivel komune të gjuhës angleze “Spelling Bee”, të organizuara nga “London School”;
- Koordinimi i organizimit të aktiviteteve për shënimin e 17 Shkurtit;
- Koordinimi i organizimit të manifestimit tradicional “Festa e Abetares” në bashkëpunim me MASH, e cila këtë vit është mbajtur në qytetin e Mitrovicës. Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë nxënës të klasave të para nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia e Veriut, së bashku me mësimdhënësit dhe përfaqësuesit e institucioneve arsimore;
- Organizimi i 2 trajnimeve në koordinim me Save the Children me temën “Qasja gjithëpërfshirëse në edukimin fizik dhe aktivitetet sportive”;
- Organizimi i Ditëve të Hapura në koordinim me Save the Children në Shkollën e Mesme Profesionale “Arkitekt Sinani” dhe “Hasan Prishtina”;
- Koordinimi i realizimit të praktikës pedagogjike për 27 studentë në institucionet tona arsimore.

Bashkëpunimi ndërinstitucional, projektet dhe hulumtimet në institucionet arsimore

- Koordinimi i organizimit të ligjëratave në shkollat e mesme të larta me temë “Agjenda e Gjelbër dhe roli i të rinjve në mbrojtjen e mjedisit dhe tranzicionin klimatik” në bashkëpunim me INDEP;
- Koordinimi i mbajtjes së punëtorisë me temën “Ndikimi i Luftërave dhe Konflikeve në Shëndetin Mendor” në bashkëpunim me OJQ “Integra”;
- Koordinimi i organizimit të sesionit informues lidhur me trajnimin për Zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me organizatat Syri i Vizionit dhe Terre des Hommes;



- Koordinimi me Kuvendin e të Rinjve të Kosovës për organizimin e Sesioneve të Rinisë me fokus arsimimin dhe mundësitë për të rinjtë;
- Koordinimi i organizimit të Kampit të Sigurisë Kibernetike në ITP Prizren në kuadër të projektit CybHER;
- Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për realizimin e vizitave higjieniko-sanitare në institucionet arsimore;
- Koordinimi i realizimit të hulumtimit mbi përdorimin aktual dhe mundësitë e integritetit të inteligjencës artificiale (AI) në procesin mësimor;
- Dhënia e lejeve për zhvillimin e 6 hulumtimeve dhe 15 aktiviteteve në institucionet arsimore;
- Koordinimi i hulumtimeve dhe projekteve të ndryshme në institucionet edukativo-arsimore.

Mbrojtja, siguria dhe parandalimi i dukurive negative në institucionet arsimore

- Koordinimi i takimeve, fushatave dhe ligjëratave në shkolla, në bashkëpunim me Njësinë e Komunitetit pranë Stacionit Policor Jug, ku janë realizuar:
 - 2 takime për shqyrtimin e rasteve të braktisjes së shkollimit;
 - 39 ligjërata në institucionet arsimore, me pjesëmarrjen e 1,759 nxënësve;
 - 3 vizita të nxënësve të shkollave fillore në Stacionin Policor, me pjesëmarrjen e 236 nxënësve, me rastin e Ditës së Policisë;
 - 2 fushata vetëdijesuese: “Dhuna në familje” dhe “Festo me zemër, jo me armë”;
 - 6 projekte vetëdijesuese: “Stop drogës”, “Përdorimi i laserëve nga të rinjtë”, “Mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet e lojërave online”, “Errësirë - Dritë”, “Ngacmimi nuk ka vend në shoqëri” dhe “Së bashku për siguri dhe buzëqeshje”;
 - 1 kamping.
- Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të projektit “Fuqizimi i Fëmijëve si Qytetarë Aktivë për të Drejtat e Tyre dhe Barazinë Gjinore” (2026–2028) në IEAA në Komunën e Mitrovicës së Jugut nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore;
- Zbatimi i aktivitetit “Youth Voices for Tolerance” (Zërat e të Rinjve për Tolerancë) dhe punëtorisë me prindër/kujdestarë (Media and Information Literacy – MIL) nga OSCE.

Sektori për Administratë dhe Financa

Plani i punës së Sektorit për Administratë dhe Financa (SAF) është përgatitur duke u bazuar në obligimet dhe detyrat që dalin nga natyra e sektorit në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Aktivitetet të cilat kryhen në kuadër të sektorit për Administratë dhe Financa janë të rregulluara me ligje dhe rregullore financiare dhe administrative për pjesën më të madhe të tyre si dhe rregulloret tjera komunale.

Aktivitetet e Sektorit për Administratë dhe Financa lidhen direkt me të gjitha çështjet Administrative dhe Financiare të Drejtorisë së Arsimit duke përfshirë edhe të gjitha shkollat e Komunës së Mitrovicës të cilat menaxhohen nga Drejtoria e Arsimit.

Konsolidimi financiar në Arsimin parauniversitar e Mitrovicës, kryesisht lidhet me Sektorin për Administratë dhe Financa. Administrimi i kërkesave për punë, furnizimet dhe shërbime të institucioneve parauniversitare në Komunen e Mitrovicës, poashtu është pjesë e planit të punës së Sektorit.

Buxheti

Në periudhën Janar – Qershor 2026, Drejtoria e Arsimit ka realizuar Buxhetin e saj në 28% total, ndërsa sipas kategorive ekonomike Buxheti është realizuar si në vijim:

- Paga dhe Shtesa 64%
- Mallra dhe Shërbime 63%
- Shpenzime Komunale 64%
- Investime Kapitale 17%

Gjithashtu Komisioni i emëruar me vendim të kryetarit për pranimin dhe shqyrtimin e lëndëve për subvencionim sipas rregullores komunale, ka kryer një pjesë të konsiderueshme të shqyrtimit të kërkesave, ku janë pranuar gjithsej 21 lëndë, prej tyre janë shqyrtuar të gjitha. Nga lëndët e pranuar janë aprovuar 10 lëndë, janë refuzuar 9 dhe në proces janë dy lëndë. Lëndët e aprovuara janë në process të pageses dhe vlera totale e tyre arrinë në 6,750.00 Euro.

Sa i përket kategorisë së Mallra dhe Shërbimeve rreth 95% e buxhetit të Drejtorisë së Arsimit këtë vit shkon për transportin e nxënësve. Prandaj edhe në kërkesën për Buxhet Sektori jonë ka kërkuar rritje të Buxhetit të DKA sepse nuk ka mundësi për të realizuar asnjë aktivitet jasht transportit të nxënësve.

Në këtë vit Drejtoria e Arsimit ka qenë në process të përfundimit të Dy projekteve kapitale, ku në periudhën Janar-Qershor 2026 është përfunduar Renovimi i SHFMU “Migjeni” dhe është realizuar 89% projekti për Ndërtimin e Çerdhes për Fëmijë në rrugën “Mbreteresha Teutë”.

Projektet tjera kapitale janë në faze procedurale, ndërsa pritet që Projekti për Ndërtimin e Shkollës Filllore "Nonda Bulka" dhe Renovimi i Gjimnazit “Frang Bardhi” të ri-destinohen sepse janë projekte të cilat pritet të ndërtohen si objekte të reja.

Në periudhën Janar – Qershor 2026, Buxheti i realizuar në arsimin parauniversitar është si në vijim :



- Arsim Parafillor (GQ 10) 66% dhe (THV 21) 27%
- Arsim Fillor (GQ 10) 56%
- Arsim i Mesëm (GQ 10) 52%

Te arsimi i Mesëm poashtu është një Investim Kapital për Kabinete në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Xheladin Deda” por i cili është në process të procedurave.

Obligimet e papaguara

Drejtoria e Arsimit nuk ka asnjë borxh ndaj Operatoreve Ekonomik pasi në 99% të rasteve zotimi i mjeteve kryhet para inicimit të aktiviteteve.

Borxhi i vetëm është një faturë e trashëguar nga viti 2021, në shumën 770.00 Euro e cila për shkak të mungesës së raportit të menaxherit të kontratës nuk ka arritur të ekzekutohet. Sektori jonë ka kontraktuar disa here me OE në fjalë për të dhën kahje këtij obligimi, mirpo nuk kemi marrë përgjigje nga ai.

Obligimet kontraktuale të Drejtorisë së Arsimit gjithsej janë 738,181.27 Euro. Prej tyre në kategorinë ekonomike të Mallra dhe Shërbimeve janë 543,562.15 Euro dhe në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale 194,619.12 Euro.

Ndryshimet në Paga

Në periudhën Janar – Qershor 2026 janë përgatitur gjithsej **276 kërkesa** për ndryshime në paga dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Lëndët e dërguara përfshijnë pranimin e kërkesave, shqyrtimin, përgatitjen e vendimeve, nënshkrimin dhe protokolimin si dhe përgatitjen e formularëve për ndryshime në paga të cilët dërgohen në Ministri të skenuara të gjitha së bashku jo më vonë se data 10 e cdo muaji.

Kërkesat kanë qenë të natyres së në vijim (duke u bazuar në kërkesat e shkollave):

- Largime 33
- Ndryshime 125
- Retroaktive 95
- Transfere bankare 23

Punët/Aktivitetet e Realizuara në periudhën Janar – Qershor 2026

- Raporti për të dhënat e kërkuara për përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin 2025.
- Përgatitja e Raportit të Punës së sektorit për vitin 2025 ku janë përfshirë të gjitha punët, angazhimet dhe aktivitete e realizuara gjatë vitit 2025 në Sektorin për Administratë dhe Financa në Drejtorinë e Arsimit.



- Përgatitja e Planit të Punës për vitin 2026, ku janë përfshirë punët, aktivitetet dhe angazhimet në baza mujore të cilat janë planifikuar për implemenim në vitin 2026 ku prej tyre shumica kanë afate ligjore.
- Drejtoria e Arsimit në periudhën Janar – Qershor 2026 ka pranuar gjithsej **989 kërkesa** të ndryshme ku përfshihen kërkesat nga institucionet arsimore parauniversitare, Drejtoritë komunale dhe kërkesat e qytetarëve të Komunës sonë. Të gjitha kërkesat shqyrtohen dhe orientohen në zyrtaret përkatës të Drejtorisë.
- Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026 janë dërguar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa mbi 300 kërkesa për zotimin e mjeteve financiare. Kërkesat përgatiten nga shkollat dhe shqyrtohet nga zytari për buxhet dhe financa dhe dërgohen në protokol. Këtu përfshihen vetëm zotimet të cilat janë mbi 100 euro dhe kërkojnë procedure prokurimi.
- Furnizimin me lëndë djegëse Dru, Pelet dhe Naftë për të gjitha Shkollat sipas kërkesës. Me furnizimet e realizuara në fillim të vitit 2026 janë përfunduar kontrata për furnizim me Dru (ka kaluar në 30%) dhe kontrata për furnizim me Pelet. Kontrata për furnizim me Naftë është kontratë përmes Agjensionit Qëndror të Prokurimit (AQP) dhe furnizimet realizohen në bazë të saj.
- Furnizimi me materiale higjienike për të gjitha shkollat, sipas kërkesës.
- Furnizimi me materiale administrative dhe pedagogjike për të gjitha shkollat sipas kërkesës.
- Furnizimi me paisje të imta për mirëmbajtjen e shkollës, sipas kërkesës së shkollave. Janë furnizuar 90% e kërkesave dhe disa janë në process të furnizimit.
- Arritja e marrveshjes dhe dërgimi i kërkesës te Drejtoria e Ambientit për mbjelljen e rreth 2000 drunjëve në institucione arsimore. Aktiviteti është në process dhe shpejt pritët fillimi i implementimit të tij.
- Rregullimi i Kalldajës së ngrohjes në SHFMU “Bislim Imeri” – Kqiq i Madh
- Rregullimi i Kalldajës së ngrohjes në Gjimnazin “Frang Bardhi” (Saldimi i gypave)
- Rregullimi i Kalldajës së ngrohjes në SHFMU “Sylejman Vokshi”
- Verifikimi i sistemit të ngrohjes në SHFMU “Fazli Greiçevci” – Paralelja e ndarë në Vërrnicë. Furnizimi me Kallda të re me Pelet, funksionalizimi i sistemit të ngrohjes dhe furnizimi me Pelet i shkollës për sezonën dimërore. Pelet është huazuar nga një shkollë tjetër në mungesës të kontratës.
- Realizimi i 89% të projektit për Ndërtimin e Çerdhes për fëmijë në rrugën “Mbretresha Teutë” ku projekti është në fazën e fundit të realizimit të punimeve dhe pritët të përfundoj në Muajin Gusht 2026.
- Përfundimi i projektit për Renovimin e Shkollës Filllore “Migjeni” në lagjen Ilirida.



- Bazuar në projektet kapitale të Drejtorisë së Arsimit, kemi dërguar kërkesën për Hartimin e projekteve kapitale në DSHPI për Rregullimin e nyjeve sanitare në shkolla fillore dhe të mesme, Ndërtimin e Infrastrukturës në oborr të shkollave fillore dhe të mesme dhe Rregullimin e objektit të SHFMU “Shemsi Ahmeti” në Shupkovc.
- Kemi filluar viziuta për skanimin dhe gjendjen e objekteve në të gjitha institucionet arsimore në Komunën e Mitrovicës, ku në fund të vitit do të dalim me një Raport të përgjithshëm të përgatitur mbi të gjitha objektet shkollore të menaxhuara nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Mitrovicës Jugore.
- Rregullimi i përvojës së punës për të gjithë mësimdhënësit dhe personelit arsimor sipas kërkesës së tyre.
- Organizimi i Ditës së Tokës, në koordinim me të gjitha institucionet arsimore në Komunën e Mitrovicës. Në këtë aktivitet është organizuar udhëtimi I nxënësve në zonat më të gjelberta në Komunën e Mitrovicës, në Shalën e Bajgore ku janë mbjellë drunjë të rinjë. Gjithashtu pjesë e aktivitetit kanë qenë të gjitha shkollat ku në koordinim me drejtoret e shkollave janë pastruar oborret e shkollave, janë mbjellë drunjë të rinj dhe janë lyer rrethojat e shkollës si dhe aktivitete tjera bashkë me personelin arsimor dhe prindërit.
- Organizimi i Festës së Abetares në koordinim me MASHTI, ku pjesëmarrës ishin 8 delegacione nga qytete të ndryshme mbarëkombëtare dhe në total rreth 2,500 pjesëmarrës duke përfshirë nxënësit, personelit arsimor dhe qytetarët e Mitrovicës.
- Realizimi I furnizimit me Laptop dhe projector nga Donacioni i Ambasades Bullgare për SHMLM “Xheladin Deda” – si pjesë e parafundit e përfundimit të projektit ku ka mbetur vetëm edhe Auditimit i projektit.
- Në Muajin shkurt jemi përballur me gjendjen e jashtzakonshme në komunën e Mitrovicës ku si sektor kemi raportuar në Shtabin Emergjent për të gjitha ndodhitë në shkollat dhe nevojat emergjente të pranuar. Aktiviteti është realizuar në koordinim me të gjithë Drejtoret e Institucioneve arsimore të menaxhuara nga Drejtoria e Arsimit. Shkollat e vetme që kanë qenë të rrezikuara ka qenë SHFMU “Shemsi Ahmeti” në Shupkovc për shkak të pozites së shkollës, ku rruga sjelle ujerat e mbledhura nga pjesa e lartë e fshatit Kqiq, mirpo kemi arritur ta menaxhojmë dhe kemi mbyllur gjendjen emergjente pa dëm të mëdha. Gjithashtu dëm ka pasur jo shumë të mëdha në SHFMU “Migjeni”, ku të reshurat kanë demtuar kulmin dhe ka arritur që uji të depertoj në Shkollë. Për të dy rastet kemi raportuar në Shtabin Emergjent të Komunës së Mitrovicës.
- Gjatë gjendjes emergjente Institucionet Arsimore kanë kontribuar me furnizimin me Pelet edhe të njësisë së Zjarrfikësve për shkak të gjendjes emergjente, dhe rrezikut të ngricave në vendin ku rrijnë



kamionët për intervenim emergjent. Peleti i marrë është evidentuar dhe kthehet nga Njesia e Zjarrfikësve në vendet ku janë marrë.

- Janë pranuar kërkesa për Inicimin e një Kontrate për Furnizim me paisje sportive, Dyer dhe Dritare si dhe materiale tjera për mirëmbajtjen e institucione arsimore. Kërkesat për zotime janë përcjellë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
- Kemi përgatitur dhe kompletuar dokumentacionin për inicimin e kontratës për Furnizim me Dru dhe Pelet dhe tashmë gjindet në Zyren e Prokurimit për procedura të mëtejme.
- Kemi përgatitur dhe hartuar specifikat edhe të kontratës së Transportit të fëmijëve me mësim të obliguar. Kemi mbajtur takim me kabinetin e kryetarit dhe jemi në pritje të sigurimit të fondeve për kompletimin e lëndës me dokumentacionet përkatëse dhe përcjelljen e tyre në Zyren e Prokurimit.
- Me ftesë nga Organizata Rinore AKTI, Sektori jonë ka marrë pjesë në Konferencën përmbyllëse të projektit trevjeçar: “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja – YEEP II”, me ç’rast DKA ka pranuar “Mirënjohje” për përkrahjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm gjatë zbatimit të këtij projekti.
- Me kërkesë nga MASHT-ti, u vizitua Gjumnazi “Frang Bardhi” për qëllim të monitorimit në kuadër të aktivitetit “Java e informimit në Gjumnaz për orientim në karrierë”, ku synimi i këtij aktiviteti ishte që nxënësit të marrin sa më shumë informata rreth mundësive ekzistuese për orientim në karrierë, si në studime ashtu edhe në punësim pas përfundimit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- Në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit dhe me Zyrtarin Ligjor të drejtorisë, Zyrtarja për Bashkëpunim Profesional ka filluar përgaditjen dhe hartimin e kontratave të reja të punës për të gjithë stafin e Punëtorve Teknik për të gjitha shkollat e Komunës së Mitrovicës, proces i cili pritet të përfundojë në fillim të muajit të ardhshëm. Vlen të theksohe se kjo ka qenë e gjetur e Zyres Kombëtare të Auditimit.
- Duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/01 të lëshuar nga Ministria e Financave kemi përgatitur kërkesën e Drejtorisë së Arsimit për Buxhetin 2027 dhe vlerësimet për vitin 2028 dhe 2029. Kërkesa përfshin një analizë të detajuar të stafit dhe nevojës financiare të institucioneve arsimore dhe DKA. Kërkesa është përgatitur duke analizuar nevojat e dy sektoreve të DKA dhe në koordinim të Drejtorit të DKA dhe udhëheqësve të Sektoreve.

Drejtori i Arsimit
Shefki Begu

